

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Bajram Peçi: Në kokat e turbullta s'ka vend për humanizmin - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/bajram-peci-ne-kokat-e-turbullta-ska-vend-per-humanizmin
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 20:21:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 17:38:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a3c32dfa5b64fd569754a434d1e5394ac9186836b21ee5757fad7faaae817964
TEKSTI	0fff7e83141530fed51eae3a05220da8d66967d3fe32ab8e148db667f1d36ce4
PAMJA	a479cee12510dd3e792135460bfa4bcf9001b2fd187cbd51e920203df9f0ff2b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9ef012a86731b3da5a0e87ff3d0c99fbad3d018a2f4ffa6c6aceb568810d9535
E MËPARSHMJA	81609b147f16d540759fd451292544ead481b0db32c5a6b5f32a57b8cdff0028
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9ef012a86731b3da5a0e87ff3d0c99fbad3d018a2f4ffa6c6aceb568810d9535>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Dronë, radarë dhe makina inteligjente në akset e Shkodrës, mbi 2200 gjopa në dy javë! 2 shoferë në pranga, 9 leje drejtimi të pezulluara



Opinion

Bajram Peçi: Në kokat e turbullta s'ka vend për humanizmin

E gjithë ceremonia e varrimit s'ishte veçse një kërcënim serioz kundër pages, kundër fqinjëve, një acarim i provokuar tensionesh e krizash



Foto nga ceremonia e varrimit për Ratko Mladić



Bajram Peçi

8 Shtator, 19:33 | Përditësimi: 8 Shtator, 19:38

f Share Tweet



A A

Krerët e Bashkimit Europian pasojnë këto orë njëri-tjetrin, duke bërë deklarata se janë të tronditur nga glorifikimi prej heroi dhe ceremonia madhështore e varrimit që qeveria e Serbisë i bëri Mlladiçit, kriminelit që ushtroi genocid dhe vrau mijra njerëz me plumb pas koke. Në Bosnje, në Republikën e Kosovës dhe në Shqipëri, është vështirë të ndeshësh kënd që të ndjehet i habitur mesa ndodh! Shumica e qytetarëve të këtyre tri shteteve, që u njohin serbëve dhëmb e dhëmballë, më së shumti i përmbahen bindjes se në Serbi shumica e banorëve të saj janë në njëfarë mënyre Mlladiça. I përket Serbisë t'ua heqi nga koka këtë "paragjykim".

Kur me urdhër vriteshin me plumb pas koke 10 mijë oficerë polakë, ata që i vrisnin nuk dinin pse ndodhte kjo? Arsyen e dinte Stalini. Masakra e Katinit e pranverës së vitit 1940, u krye me urdhër të Byrosë Politike të Bashkimit Sovjetik – Stalinit, Molotovit, Kaganoviçit, Voroshilovit, Mikojanit dhe Kalininit, që nënshkruan urdhërin për të ekzekutuar 25.700 polakë, të cilët ndodheshin në kampe dhe burgje në Ukrainën dhe Bjellorusinë Perëndimore, strehuar atje pas sulmit të hordhive naziste mbi Poloninë. Bashkimi Sovjetik nuk ishte në luftë me Poloninë, por i ashtuquajturi pakt (i fshehtë) mes Ribentropit dhe Molotovit, më 23 gusht 1939, e kish ndarë Poloninë mes tyre. Ndërsa në Srebrenicë, Më 11 korrik të vitit 1995, kur Mlladiç urdhëronte të vriteshin (po me plumb pas koke) 8 mijë qytetarë boshnjakë, djem e burra të pa armatosur, paqësorë, rrëmbyer nga shtëpitë e tyre, arsyeja dihej: të shfarrosen të gjithë ata që nuk janë serbë dhe nuk i përkasin besimit të tyre fetar. Nuk i vrau Mlladiç me dorën e tij, por disa qindra Mlladiçë të tjerë.

Bota e tromaksur nga ky krim i përbindshëm, i lejuar të ndodhte edhe prej trupave paqruajtëse holandeze, u vu në lëvizje, nga ku, nën diktimin amerikan, u vendos paqja e brishtë e Dejtonit.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:
Një aiqa kundër kombit shqiptar



E thënë në mënyrë të përmblëdhur, ceremonia e varrimit u shndërrua në një pasqyrë për t'i treguar botës se Serbia ka qenë e mbetet po ajo agresore që provokoi luftrat në ish Jugosllavi, që luftoi përbindshëm kundër kroatëve, që rrethoi për vite Sarajevën dhe kreu krime të llahtarshme me gjuetinë kundër fëmijëve dhe grave, që ndër morri genocidin kundër shqiptarve në Kosovë, që provokon pareshtur me sjellje dhe veprime popullin shqiptar.

Nën ritet ortodokse priftërinjtë bekuan udhëtimin e Mlladiçit në përjetësi, ashtu siç kishin bekuar armatën serbe për vrasjen masive të popujve fqinjë. Në kokat e turbullta të elitës politike në pushtet, nën shembullin e presidentit hipokrit Vuçiç, që u përfaqësua në varrim prej familjes së tij, nuk pati asnjë moment ktjellimi prej ndokujt që të kuptonte se ceremonia ishte një ditë shkatërruese për popullin e tyre. Ata që bëjnë politikën europiane, me gjasa, pas tri ditësh do ta kenë harruar këtë ceremoni dhe do fillojnë nga qokat, por populli boshnjak dhe ai shqiptar nuk do ta harrojnë kurrë! Për shumë studiues të Ballkanit, me ngjarjen e përjetuar të ceremonisë shtetërore të varrimit të kriminelit, do mund t'i kuptojnë shumë gjëra edhe më qartë! Nderi prej heroj që i bënë Mlladiçit do t'i bëjë historianët të njohin më saktësisht rajonin dhe t'i japin përgjegje opinionit ndërkombëtar se pse Serbia po armatoseq kaq vrullshëm dhe kundër kujt përgatitet të sulmojë në këtë rajon të gjymtuar nga luftrat?!

Serbia, sipas asaj që shkruante në kohën e tij, Lamartine, (mesi i shek.XIX), "...nuk ishte gjë tjetër veçse një oqean pyjesh, që kishte më shumë derra se njerëz". Në vitin 1841, Blanqui shkruante nga Beogradi se "...disa baraka, një spital, një ndërtesë burgu, lajmërojnë praninë e një qytetërimi në zhvillim". A e ndihmuan vallë këto ngrehina dhe të tjera më pas, që ta fusnin popullin serb në rrugën e qytetërimit, të humanizmit njerëzor, të popullit që di të jetojë në fqinjësi të begatë e mirëkuptim? Kjo ceremonia e varrimit shërbeu përpos se t'i largojë popujt e Ballkanit edhe më! Si gjithnjë, shkaktare pse ndodh kështu, është Serbia?

E gjithë ceremonia e varrimit s'ishte veçse një kërcënim serioz kundër paqes, kundër fqinjëve, një acarim i provokuar tensionesh e krizash. Të jemi syçelët!

S.I.E./Shqiptarja.com

TAG: [bajram peçi](#) [Ratko Mlladiç](#) [homazhet per ratko mlladic](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



5.0 / 5 (1 vlerësim)

OPINIONET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet reprintsisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Copa pushtetesh, secili për vete, Zoti për të gjithë!



Bajram Peçi

11 Shtator, 22:37



Ardit Rada: Lista e Kryetares së Kuvendit



Ardit Rada

10 Shtator, 08:35



Shqipëria dënon nderimet e Mlladiç në Beograd, Hoxha: Glorifikimi i kriminelëve të luftës bie ndesh me vlerat evropiane

8 Shtator, 20:13



Varrimi me nderime të larta i Ratko Mlladiç, Komisioni Eurasion



Britania thërret ambasadorin serb për shprehje me nderime



Kallas i dërgon mesazh Serbisë: Lavdërimi i një kriminelit luftë është

Komisioni Evropian paralajmëron rishikimin e negociatave me Serbinë

8 Shtator, 19:25



Pas funeralit të Mlladiçit, Bosnja dëbon 2 diplomatë serbë! Ministri i jashtëm: Kanë 48 orë të largohen, me këtë Serbi s'ka marrëdhënie të fqinjësisë së mirë

8 Shtator, 16:40

Sqarime pas nderimeve për Mlladiçin: Glorifikimi i një kriminelit lufte nxit përçarjet në rajon

8 Shtator, 19:05



Nderimet për Ratko Mlladiçin, në Bruksel shtohen thirrjet për ndërprerjen e negociatave të anëtarësimit me Serbinë, gazetari: Do të jetë kandidat vetëm në letër njësoj si Turqia

8 Shtator, 14:27

Ndërmjet lufte është fyerje për viktimat

8 Shtator, 17:01



Nderimet për Mlladiçin shkaktjnë reagime në Kroaci, Jandroković: Serbia po bën propagandë jashtëzakonisht të pistë ndaj fqinjëve!

8 Shtator, 14:16



BE paralajmëron rishikimin e negociatave me Serbinë pas nderimeve për Ratko Mlladiçin! Von der Leyen: Pamje tronditëse, Bosnja dëbon 2 diplomatë

8 Shtator, 12:56



Serbia varrosi Mlladiçin me ceremoni, Kurti akuzon Beogradin për adhurim të genocidit

8 Shtator, 12:46



I dërgoi ngushëllime familjes së Ratko Mlladiçit, partia shqiptare në qeveri kërkon shkarkimin e kryetarit të Kuvendit të Malit të Zi

8 Shtator, 10:32

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kësaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.